



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Nivelo Org. Org. Jedinitas Org. Unit:	02
Pr. Post. Pr. Post. Pr. Post.:	05-4789
Pr. Faqeve Pr. Stranica No. pages:	-5-
Data: Date:	09/08/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE TË FLAKONËVE TË PËRDORUR TË VAKSINAVE
COVID-19 DHE MATERIALIT TJETËR NDIHMËS

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE: [VIII]
NR. I NËNHAPAVE: [XX]

APROVUAR:

Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



MINISTRIA E SHËNDETËSISË

PSO: MENAXHIMI I MBETURINAVE TË FLAKONËVE TË PËRDORUR TË
VAKSINAVE COVID-19 DHE MATERIALIT TJETËR NDIHMËS

QËLLIMI	<p>QËLLIMI PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË TË PËRSHKRUHET PROCESI I MENAXHIMIT TË FLAKONËVE TË HUDHUR DHE MBETURINAVE TJERA NDIHMËSE PAS PËRFUNDIMIT TË VAKSINIMIT ME VAKSINËN KUNDËR COVID-19.</p> <p>PSO-JA OFRON UDHËZIME TË QARTA SE SI TË BËHET TRAJTIMI I DUHUR DHE ASGJËSIMI I SIGURT I KËTYRE MBETURINAVE, PËR TË MINIMIZUAR ÇDO RREZIK SHËNDETËSOR.</p>
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. LIGJI NR 04/L190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE; 4. UA MPMH NR 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.
LISTA E SHKURTESAVE	<p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>MMPHI – MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS;</p> <p>OBSh – ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË;</p> <p>PPM – PAJISJE PERSONALE MBROJTËSE;</p> <p>PSO – PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE.</p>

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Grumbullimi i Flakonëve të Vaksinës Kundër COVID-19	<ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo flakon i përdorur ose i hudhur i vaksinës kundër COVID-19 duhet të grumbullohet në mënyrë të sigurtë dhe veçmas nga pjesa tjetër e mbeturinave; 2. Si flakonet bosh, ashtu edhe ato me dozat e mbetura të vaksinës të hedhura në fund të aktivitetit ditor të vaksinimit mblidhen dhe ruhen në mënyrë të sigurt deri sa ato mblidhen për trajtimin dhe asgjësimin përfundimtar; 3. Flakonët duhet të numërohen dhe regjistrohen nga ekipi përgjegjës me qëllim të analizimit të aktivitetit të vaksinimit (p.sh. shfrytëzimi, mbulimi, shpërdorimi, etj.); 4. Flakonët e përdorur duhet të mblidhen në qese rezistente ndaj rrjedhjeve, mundësisht me jo më pak se 40-50 mikron dhe jo më shumë se 15l, për t'u përshtatur në dimensionin e hapësirës kryesore të incineratorëve në dispozicion; 5. Rekomandohet vendosja e mbeturinave në qese të dyfishta dhe vendosja e ndonjë materiali absorbues (p.sh. letra, jastëk absorbues ose të ngjashme), për të absorbuar çdo rrjedhje të mundshme nga materialet e mbeturinave.
[II]	Grumbullimi i Shiringave dhe Mbeturinave tjera Ndihmëse për Vaksinim	<ol style="list-style-type: none"> 1. Paralelisht, të gjitha mbetjet e mprehta (p.sh. gjulpërat, shiringat automatike, bisturitë, etj.), duhet të grumbullohen brenda konteinerit të përshtatshëm dhe të dedikuar, si p.sh. konteineri i mjeteve të mprehta ose kutitë e sigurta.
[III]	Grumbullimi i Mjeteve/Materialeve Tjera të Përdorura/Mbetura (PPM, tupfera, pambuk etj.)	<ol style="list-style-type: none"> 1. PPM të përdorura tupfera, pambuku dhe mbeturinat tjera duhet të grumbullohen në qese rezistente ndaj rrjedhjeve, mundësisht me jo më pak se 40-50 mikron dhe jo më të mëdha se 15l për t'u përshtatur në dimensionin e hapësirës kryesore të incineratorëve në dispozicion.
[IV]	Deponimi i Përkohshëm i Mbeturinave në Institucion	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në fund të secilës ditë, pas kthimit në bazë/qendër pas numërimit, regjistrimit të numrit të flakonëve dhe shiringave të përdorura, mbeturinat mund të transferohen në një konteiner të dedikuar për materialet potencialisht infektive;

		<ol style="list-style-type: none"> 2. Konteineri duhet të ketë kapak të sigurtë i cili mbyllet mirë; 3. Konteineri duhet të pastrohet dhe dezinfektohet pas secilit përdorim dhe duhet të jetë i gatshëm për përdorim ditën në vijim; 4. Të gjitha mbeturinat e gjeneruara (flakonët e vaksinës së COVID-19 të hedhura, mjete të mprehta të përdorura si dhe mbeturinat e tjera të ngurta), duhet të ruhen në një vend të mbyllur mirë në bazë, derisa të bëhet trajtimi dhe asgjësimi i tyre përfundimtar; 5. Vendi i deponimit të mbeturinave duhet të mbikëqyret dhe në të duhet të ketë qasje vetëm personi përgjegjës.
[V]	Deponimi i Mbeturinave të Grumbulluara	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjitha mbeturinat e grumbulluara duhet të ruhen në kushtet e poshtëshënuara derisa të bëhet largimi në vendin e asgjësimit të tyre: <ol style="list-style-type: none"> a. të mbrohen nga dielli dhe të sigurohet integriteti i pakove në të cilat janë vendosur; b. të mbrohen nga shiu dhe uji, të sigurohet integriteti i pakove në të cilat janë vendosur dhe të shmanget rrjedhja dhe përhapja e produktit me ujë. Uji në kontakt me mbeturina duhet të grumbullohet dhe menaxhohet sikurse pjesa tjetër e mbeturinave; c. të mbrohen nga brejtësit për të siguruar integritetin e pakove ku janë të vendosura dhe të shmanget përhapja e mbeturinave; d. të izoloohen nga burimet e ushqimit dhe ujit për të shmangur kontaminimin; e. të mos ketë mundësi kontakti me stafin për të shmangur manipulimin joadekuat dhe ekspozimin aksidental ndaj reagjentëve dhe produkteve tjera.
[VI]	Trajtimi i Flakonëve të Përdorur të COVID-19 Para Asgjësimit të Tyre Përfundimtar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Para zbatimit të procedurave të poshtëshënuara duhet të lahen duart dhe të vendosen dorëzat kirurgjike me qëllim të mbrojtjes personale: <ol style="list-style-type: none"> a. para fillimit të ndonjë procedure të trajtimit të flakonëve të vaksinave, largoni të gjithë kapakët e flakonëve (me mbështjellës alumini) dhe shenjëzimet e tyre (etiketat – nëse kanë) për të siguruar trajtimin efektiv të tyre; b. grumbulloni të gjithë kapakët në një qese plastike dhe mënjaroni për incinerim të mëvonshëm. Pas përfundimit të këtyre procedurave, flakonët janë të gatshëm për trajtim.

[VII]	Trajtimi me Tretësirë të Klorit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dezinfektimi i flakonëve të përdorur me tretësirë të klorit 0.5%, është shpeshherë metoda më e shpejtë dhe më e lehtë; 2. Përgatitni tretësirën dezinfektuese 0.5%, varësisht nga sasia e cila është e mjaftueshme për të mbushur konteinerin e plastikës me flakonë të hudhur; 3. Me dorëza të trasha, zhytni flakonët në tretësirën me klor, duke u siguruar që tretësira dezinfektuese të futet brenda secilit flakon dhe prek të gjitha sipërfaqet. Lërimi të reagojnë për së paku 30 minuta; 4. Pas 30 minutave, largoni të gjithë flakonët nga tretësira dezinfektuese. Sigurohuni të vendosni dorëza të trasha dhe se të gjithë flakonët janë të zbrazur. Grumbulloni flakonët për asgjësimin e tyre përfundimtar; 5. Tretësira e përdorur (klor 0.5%) duhet të hudhet në mënyrë adekuate dhe të sigurtë për të mbrojtur ambientin dhe vetë personin.
[VIII]	Trajtimi me Sterilizim Përmes Autoklavit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nëse është në dispozicion autoklavi, përdorni atë që në mënyrë efektive të sterilizohen flakonët e hudhur të vaksinave, para asgjësimit të tyre përfundimtar: <ol style="list-style-type: none"> a. fillimisht lani duart dhe vendosni dorëzat kirurgjike; b. vendosni flakonët brenda autoklavit duke ndjekur instruksionet specifike për përdorim të pajisjes; c. ndezni autoklavin dhe lejoni përfundimin e procesit të sterilizimit; d. grumbulloni flakonët e sterilizuar nga autoklavi për asgjësimin e përfundimtar.
SQARIM		Kjo PSO është hartuar bazuar në dokumentin e OBSH-së <i>'Standard operating procedure (SOP), Waste management of used COVID-19 vaccines vials and ancillary supply'</i>